

# BULETINI JAVOR

## 22-26 JANAR 2024



Shprehja

"Siguria kibernetike: Mbrojtja e kufirit tuaj digjital me vigjilencë dhe qëndrueshmëri."

e javës

Përmbajtja:

- AKCESK në takim me Institucionet Financiare
- HPE - data breach
- Apple - patching alert



### AKCESK në takim me Institucionet Financiare

Ngjarjet kibernetike në të cilat po kalon Shqipëria së fundmi, mbledhën në një tryezë diskutimesh ditën e djeshme, datë 23 janar, AKCESK dhe drejtuesit e lartë të institucioneve të sektorit financiar.

Në takim, Koordinatori Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, z. Igli Tafa, theksoi rëndësinë e rolit të investimeve në këtë sektor të infrastrukturave kritike për rritjen e sigurisë kibernetike. Të pranishmit u njohën me domosdoshmërinë e forcimit dhe mbrojtjes kibernetike të institucioneve duke u fokusuar në disa hapa:

Investime në Teknologji - nevoja për përdorimin e teknologjive të fundit të mbrojtjeës kibernetike për të mbrojtur informacionin dhe të dhënat e klientëve.

Masat Operacionale - ngritja e standarteve të sigurisë së përditshme të institucionit nga ana operacionale dhe administrative sipas referencave NIST ose ISO 27001.

Niveli Menaxherial - roli i liderit në detyrimin e institucionit për të investuar në ngritjen e ndërgjegjësimit e stafit në kuadër të sigurisë kibernetike, në përcaktimin e buxhetit në fushën e sigurisë kibernetike si edhe në përcaktimin e rrezikut kibernetik në mënyrë të vazhdueshme.

Rritja e Kapaciteteve - Investim në rritjen profesionale të eksperteve dhe mbulimin e vakancave të evidentuara në fushën e sigurisë kibernetike.

Në takim u theksua nevoja e rritjes së bashkëpunimit mes AKCESK dhe sektorit financiar për të ndarë sa më shumë informacion dhe për të ndërmarrë masat e duhura, në kohën e duhur, që sigurojnë një ekosistem të sigurt kibernetik. Aty u theksua dhe nevoja për një qasje të vazhdueshme dhe aktive, në bashkëpunim konkret, për të adresuar sfidat kibernetike në të ardhmen.

AKCESK kërkoi që sektori financiar të bashkërendojë punën me veprime konkrete për implementimin e masave të shtuara të sigurisë për vitin 2024.



### HPE - data breach


Sulmuesit Kibernetik të njohur si APT29 dyshohet se kanë infiltruar në platformat cloud të kompanisë së teknologjisë së informacionit Hewlett Packard Enterprise (HPE) për të shfrytëzuar të dhënat në mailbox.

Aktori i kërcënimit aksesoi dhe nxorri të dhëna duke filluar nga maji i vitit 2023 nga një përqindje e vogël e malibox-eve që u përkasin individëve në sigurinë kibernetike, bizneseve etj.

HPE, megjithatë, theksoi se incidenti nuk ka pasur ndonjë ndikim material në operacionet e saj deri më sot.

[Link: Lexo më shumë](#)

### PATCHING ALERT



### Apple - patching alert

Apple ka publikuar së fundmi përditësime sigurie për të adresuar një vulnerabilitet të tipit zero-day, i cili është shfrytëzuar aktivisht nga sulmuesit.

Vulnerabiliteti i identifikuar si CVE-2024-23222 është një problem në motorin e shfletuesit WebKit, i cili mund të shfrytëzohet nga një aktor kërcënimi për të arritur ekzekutimin arbitrar të kodit.

Gjiganti i teknologjisë tha se problemi u rregullua me kontrolle të përmirësuara.

[Link:Lexo më shumë](#)